

Bariu dëgjoftë zërin e deleve...



Kisha online Jeta

ORGAN I PËRMUAJSHËM INFORMACIONI I METROPOLISË TIRANË-DURRËS Nr. 6 QERSHOR 2017 Çmimi 30 lekë

Sh. T. Imzot George Frendo
pranon Paliumin e Metropolitit
të Arkidioqezës Tiranë-Durrës



BARIU DËGJOFTË ZËRIN E DELEVE...

Shkëlqesia e Tij Imzot
George Frenco, merr
Paliumin e Metropolitit *faqe 3-4*

Papa Françesku: Tre
emërime të reja
ipeshkvore në Shqipëri *faqe 5-6*

Ati i shenjtë kërkon edhe
fundin e konflikteve e
zgjidhje për fenomenin e
emigracionit. *faqe 7*

Kalorës i Urdhërit të
Skënderbeut
Nga Ferdinand NDOCAJ faqe 7

Një vlerësim i merituar
nga Presidenti i Shqipërisë
për prof. Dr. Jul Bushatin
- Mjeshtër i madh *faqe 8*

Lëvizja për Jetën në Shqipëri
Lërin Fëmijët të vijnë tek unë
Nga. Dr. Majlinda GJONI faqe 9

Kushtet Solemne në
Shoqërinë e Jezusit
Atë Zef Bisha dhe Atë
Stefano Corticelli
Nga Ferdinand NDOCAJ faqe 11

Kalendari Liturgjik

Korrik-Gusht 2017

KORRIKU

- 03 korrik SH. TOMA APOSTULL
04 korrik Sh. Elisabeta e Portugalisë
05 korrik Sh. Anton Maria Zakaria
06 korrik S. Maria Goreti
07 korrik Sh. Asti
11 korrik SH. BENEDIKTI pajtor i Europës
13 korrik Sh. Enrriku
16 korrik Virgjëra Mari e Malit Karmel
17 korrik Sh. Aleksii e Shën. Klaudia
18 korrik Sh. Frederiku
20 korrik Sh. Apolinari
22 korrik Sh. MARIA MAGDALENË
23 korrik Sh. Brixhida
25 korrik SH. JAKOBI APOSTULL
26 korrik Sh. Joakimi e Sh. Ana
27 korrik Sh. Liljana
29 korrik Sh. Marta
30 korrik Sh. Pjetër Krizologu
31 korrik Sh. Injaci i Lojolës

GUSHTI

- 1 Gusht Sh. Alfonsi
6 gusht Shndërrimi i Zotit
7 gusht h. Sisti e Sh. Gajtani
8 Gusht Sh. Domeniku
9 Gusht Sh. Benedikta e Kryqit (Edit Shtain)
10 gusht Sh. Lorenci
11 Gusht Sh. Kjara
14 Gusht Sh. Maksimiliani
15 Gusht Të Ngjiturit e të LV Mari
19 Gusht Sh. Gjoni Eudes
20 Gusht Sh. Bernardi abat
22 Gusht Sh. Maria Virgjër e Mbretëreshë
23 Gusht Sh. Roza
24 GUSHT SH. BARTOLOMEU APOSTULL
27 GUSHT Sh. Monika
28 GUSHT Sh. Agustini
29 SH. GJON PAGËZUESI



Drejtor i përgjithshëm:
Imzot George Frenco
Kryeredaktor:
D. Marjan Lumçi
Sekretar:
Ferdinand Ndocaj

Redaksia:
Kolec Çefa
Ana Stakaj
Zef Skanjeti
Elidon Dodaj

Grafika:
Pjerin Sheldija
Foto: Pici

Adresa:
Katedralja e Shën Palit,
Bulevardi Zhan D'Ark,
Tiranë, Shqipëri
E-mail: kisha.jeta@gmail.com
www.kishadhejeta.com

Shkëlqesia e Tij Imzot George Frendo, merr Paliumin e Metropolitit

Tiranë 2 korrik 2017

Fjala përshëndetëse e Famullitarit të Katedrales në fillimin e kremtimit Eukaristik

Kjoftë levdu Jezu Krishti

Vllazën e motra të dashtun, Kremtimi Eukaristik që sapo kena nisë, Buka e Gjallë që na mbledhë çdo të diele përreth elterit, sot na ban me u ndi ma të gëzueshëm dhe ma shumë të bashkuem në lutje përreth Arqipeshkvit tonë Imzot Gjergj Frendo, i cili vetëm tre ditë ma përpara ka pranue Paliumin Metropolitan prej Atit të Shejtë Papës Françesku.

Bashkë me Ju të gjithë i uroj mirëseardhjen në këtë Katedrale Eminencës së Tij Kardinalit tonë Ernest Troshani, i cili në të vërtetë nuk asht hera e parë që na viziton në këtë katedrale, por që sot i jep nder bashkimit tonë duke ba që në një farë mënyre Kisha Dëshmitare e së sotshmes të ndihet e bashkueme më Kishën Martire të së djeshmes.

Arqipeshkvi i ynë do ta marrin Paliumin e Shejtë prej duerve të Nuncit Apostolik Shkëlqesisë së Tij Imzot Charles John Brown, Ambasador i Selisë Shejte pranë shtetit tonë. Në të vërtetë Nunci në pak kohë që gjendet mes nesh na e ka shprehë afërmitetin e tij me praninë e tij të shpeshtë në këtë Katedrale, dhe bashkë me mirëseardhjen do të doja që ta falënderoj edhe një herë për kremtimin e bukur dhe plot të entuziazëm të 7 vjetorit të Lëvizjes për Jetën të cilën e kremtuam bashkë me ju besimtarë para dy ditësh.

Ju uroj mirëseardhjen edhe të gjithë ipeshkvi-je të pranishëm në këtë kremtim të cilët kanë dashtë që të bashkëndajnë me ne gëzimin e kësaj dite të veçantë për Arkidioqezën tonë.

Një mirëseardhje të ngrohtë në mesin tonë due që në emnin e të gjithë juve t'ja jap edhe themeluesve të bashkësisë "Casa di Maria" - Shtëpia e Marisë në Rromë, Dom Giacomo Martinelli dhe Motër Nicoletta Reschini, të cilët janë të pranishëm në mesin tonë sot duke na sjellë si dhuratë Vikarin e ri të Arkidioqezës sonë Dom Arjan Dodën, i cili me pranimin e kësaj shërbese të re, do të jetojë në mesin tonë për të ndihmue që Arkidioqeza jonë të rritet në fe dhe të forcohet në vllaznim.

Në këtë Meshë do të përkujtojmë me falënderim dhe lutje të përshpirtshme në mënyrë të veçantë shpirtin e Imzot Rrok Mirditës, Arqipeshkvit të parë të kësaj Selie Arqipeshkvore, si dhe shpirtin e Nuncit të Parë Apostolik Imzot Ivan Diaz i cili para pak ditë kaloi në amshim në Shtëpinë e Atit qiellor.

Të gjithëve ju uroj Meshë të Shejtë me praninë e Shpirtit të Zotit.



Predikimi i Shkëlqesisë së Tij Imzot George Frendo, në kremtimin Eukaristik në të cilin mori mbi vete Paliumin e Metropolitit.

Një nga tiparet më spikatëse të popullit shqiptar është mikpritja e madhe e tij. Në atë që quhet Kanuni i Lekë Dukagjinit flitet me shumë detaje për shpirtin me të cilin shqiptari duhet të pranojë mikun. Ndër të tjera lexojmë: "Shtëpia e shqiptarit është e Hyjit dhe e mikut"; dhe: "Miku nderohet duke i ofruar bukë, kripë e zemër". Dhe ky shpirt mikpritës, që uroj që popullit tonë mos i mungojë kurrë ta, ka një porosi shumë të veçantë dhe shumë të rendësishme për botën e sotme. Shumë popuj sot kanë humbur atë ndjesi mikpritjeje që në të kaluarën e kishte kultivuar. Shumë popuj sot jetojmë në anonimitet ose në atë që Papa Françesku ka quajtur "globalizimi i indiferencës".

Leximi i Parë sot na paraqet një çift që ka treguar një mikpritje të veçantë ndaj një profeti me emrin Elizeu. Për ca kohë, çifti i ofronte bukë çdo here që ai kalonte anej. Më vonë çifti vuri re se ky person ishte "njeri i Hyjit, njeri i shenjtë", dhe vendosën t'i ndërtonin një dhomë në tarracë. Kanë treguar një bujari mikpritjeje të veçantë, dhe Zoti i shpërbleu.

Terë misioni i profetit Elizeu tregon gjithash-



tu ndjeshmërinë e tij ndaj njerëzve më të braktisur apo të mënjeluar: një vejushë, një lebroz, shumë njerëz të uritur, njerëz të varfër. Profeti nuk ngurron të bashkohet me ata që bota i braktis ose i paragjykon.

Edhe Jezusi, në Ungjill, flet për mikpritje. Ja fjalët që kemi dëgjuar në ungjill: "Kush pranon profetin pse është profet, do të marrë shpërblimin që i takon profetit; kush pranon të drejtin pse është i drejtë, do të marrë shpërblimin që i takon të drejtit. Kush ia jep ndonjërit prej këtyre të vegjëlve, madje edhe një gotë uji të freskët, pse është nxënësi im, për të vërtetë po ju them: nuk do t'i humbë shpërblimi!" Pra bëhet fjalë me një formë edhe më fisnike mikpritjeje, sepse është një mikpritje që bëhet në emrin e Krishtit. Prandaj Jezusi tha: "Kush ju pranon ju, më pranon mua; e kush më pranon mua, pranon Atë që më dërgoi mua".

Ky Ungjill na paraqet tri kategori njerëzish që mbartin mbi vetë përngjasimin e Jezu Krishtit: *profeti, i drejti dhe i varfri*. Dhe kjo na ndihmon të kuptojmë cila është Kisha që ne duhet ta ndërtojmë. Rasti i sotëm, dorëzimi i paliumit mbi shpatullat e mia, na kujton se jemi Kishë, Kisha e Krishtit, që, duke gëzuar praninë e Krishtit, përjeton gjithmonë atë njësi që e bën një familje të madhe. Dhe këto fjalë që sapo kam cituar nga Ungjilli i sotëm na tregojnë cilat janë tiparet që Kisha e Krishtit duhet të pasqyrojë në Shqipëri dhe për të cilat duhet të angazhohet. Jezusi ka lavdëruar ata që pranojnë një profet, një të drejtë, dhe një të varfër. Ja *si* duhet të jetë, *ku* duhet të veprojë, dhe *për çfarë* duhet të angazhohet Kisha në Shqipëri.

Përmend së pari të varfrit. Jemi Kisha e Krishtit, e Krishtit të mishëruar. Mishërimi i Krishtit do të thotë atë pasuri të fshehur në varfëri; ose, në fjalët e Shën Palit, "Jezu Krishti, duke qenë i pasur, u bë për ju i varfër, që ju të bëheni të pasur me anë të varfërisë së tij". Për

këtë arsye Jezusi u tregua shumë i ndjeshëm ndaj të varfërve; madje u identifikua me të varfrit kur tha: “Çkado bëtë për njërin ndër këta vëllezërit e mi më të vegjël, e bëtë për mua.” Dhe, në Ungjillin e sotëm: “Kush ia jep ndonjërit prej këtyre të vegjëlve, madje edhe një gotë uji të freskët, pse është nxënësi im, për të vërtetë po ju them: nuk do t’i humbë shpërblimi!” Si Kishë e Krishtit le të bëhemi zë për ata që nuk kanë zë, për atë që ka nevojë të bëjë një operacion, por i mohohet kjo e drejtë, sepse nuk mund të paguajë lekët që kërkon mjeku i korruptuar; për atë që nuk gjen punë, sepse nuk njih asnjë deputet që mund ta fusë në punë; për atë të cilit i mohohet një vendim i drejtë në gjykatë sepse gjyqi u shit për një shumë të madhe lekësh nga një person shumë i pasur.

Së dyti përmend të drejtët. Jezusi tha: “Të lumët janë ata që kanë uri dhe etje për drejtësi”. Sot e ndiejmë shumë “urinë” për drejtësinë shoqërore. Kush janë të drejtët? Janë ata që nuk pranojnë të shiten për të votuar për një parti politike në zgjedhje, sepse e dinë se e mira e përbashkët duhet të ketë përparësi mbi fitimin personal. Është ai polic që nuk shitet për një kafe. Është ai deputet që në kuvend nuk ka frikë të denoncojë një projekt-ligj që kundërshton parimet morale, dhe ka kurajë ta mbrojë martesën si bashkim mes një burri dhe një gruaje. Është ai që nuk është lakmues për pasuri, për pushtet, për zbatimje. Si Kishë ne duhet të angazhohemi për promovimin njerëzor dhe çlirimin e njeriut: për dinjitetin e gruas, respektin për të varfërit dhe të mënjanuarit, etj. Është një angazhim për ndërtimin e një shoqërie më të denjë për njeriun. Angazhohemi jo si “sindakalist” ose thjesht si punëtorë shoqërorë, por si deshmitarë të ungjillit, të frymëzuar nga Fjala e Zotit. Vaj për ne nëse bëjmë një lloj jetese të qetë, duke arsyetuar: “Nuk është puna ime...”. Misioni



ynë na detyron të qëndrojmë jo aq afër atyre që sundojnë, por më shumë afër viktimave të padrejtësisë.

Dhe së treti përmend profetët. Leximi i Parë ka folur për çiftin që pranoi profetin Elizeu. Jezusi lavdëroi ata që pranojnë profetin sepse është profet. Kush janë profetët? Jemi ne ipeshkvinj, jemi ne meshtarë, jemi të gjithë ne besimtarët. Dhe çfarë bën profeti? Profeti nuk është ai që paralajmëron të ardhmen, por ai që predikon të tashmen. Domethënë ai që shpall vlerat e vërteta, në kundërshtim me vlerat fallco që shpall bota e sotme. Profeti shpeshherë duhet të ecë kundër rrymëve. Shën Pali ka thënë: “Mos iu përshtatni parimeve të shekullit”. Me kurajën e Jeremisë, lejojmë vetveten të “ngashënjehemi” nga Zoti. Me kurajë të themi

“po” ose “jo” kur duhet të themi “po” ose “jo”. Me kurajë të marrim vendimin e duhur e të themi fjalën e duhur edhe duke ditur se do të kritikohemi. Me kurajën të lejosh Fjalën të të shndërrojë që të mund të shpallesh të vërtetën që liron. Me kurajën e Isaisë, i cili tërhoqi vëmendjen e popullit për jetimët dhe vejtashat dhe të shtypurit, duke qortuar ata që vazhdonin të hanin dhe të pinin dhe të zbaviteshin kinse gjithçka ishte në rregull. Me kurajën e Amosit dhe të Ozesë, që sot tërheqin vëmendjen tonë për ata që po vriten në luftra në Siri dhe në Irak, fëmijët që po vdesin nga uria në këto vende dhe në shumë vende në Afrikë.

Në pjesën e parë të Ungjillit të sotëm Jezusi tha: “Kush e do të atin e të ëmën më shumë se mua”. Kush lexon këto fjalë në mënyrë siperfaqësore mund të mendojë se Jezusi na nxit të injorojmë prindërit dhe familjarët tanë. Nuk është e vërtetë. Madje ishte Jezusi që i qortonte fortë farisenjtë sepse thoshin se nuk kemi asnjë detyrë ndaj prindërve, por vetëm ndaj Zotit. Por Jezusi tregon se thirrja e tij ka përparësi mbi çdo thirrje tjetër, edhe mbi atë të prindërve. Sa shumë prindër kanë penguar planin e Zotit kur nuk kanë lejuar që djali i tyre të vazhdojë rrugën për t’u bërë prift! Sa prindër kanë penguar vajzat e tyre mos të pranoinin planin e Zotit që të bëhen murgeshë!

Vëllezër e motra, bota e sotme ka nevojë të dëgjojë Ungjillin e Krishtit. Bota e sotme ka nevojë për ne. Ka nevojë për secilin prej nesh, por jo thjesht si të krishterë. Secili prej nesh duhet të jetë jo thjesht një “i krishterë”, por një “Krisht tjetër”, që në praninë tonë të kenë turp ata që mbjellin padrejtësi, korrupsion dhe urrejtje, sepse shohim në ne figurën e apostujve të dashurisë, që hapim rrugën për një revolucion: i vetmi revolucion që është i lejueshëm, madje i detyrueshëm: është revolucion i dashurisë!



Papa Françesku: Tre emërimet të reja ipeshkvore në Shqipëri



Në këtë numër të “Kisha dhe Jeta”, përzhemërsisht gjejmë rastin të përshëndesim emërimin e tre ipeshkijve të emëruar nga Papa Françesku. Urojmë që Zoti t’ua ndriçojë atyre rrugën, në angazhimin që do të kenë në dobi të besimtarëve, të dioqezave përkatëse ku do të zhvillojnë veprimtarinë baritore, por edhe në dobi të vendit tonë. Në vijim po pub-

likojmë lajmin 15 qershorit të ardhur nga Selia e Shenjtë:

“Tre emërimet ipeshkvore të Papa Françesku, në Shqipëri. Papa ka pranuar sot dorëheqjen e drejtimit baritor të dioqezës së Rrëshenit, të paraqitur nga Imzot Cristoforo Palmieri, dhe ka emëruar ipeshkëv Imzot Gjergj Metën, i cili deri tani ka qenë Vikar Gjeneral i Arkidioqezës së Tiranë-Durrësit.

Atë Giovanni Peragine, deri tani famullitar i Shën Nikollës në Milot, në Arkidioqezën e Tiranë-Durrësit, është Administratori i Ri Apostolik i Shqipërisë Jugore: ndjekës i Imzot Hil Kabashit, që ka qenë deri tani i ngarkuar me këtë detyrë. Papa, në fund, ka emëruar ipeshkëv të Sapës don Simon Kullin, deri tani Administrator Dioqezan i së njëjtës dioqezë”.

Përshëndetje e P. Giovanni Peragine ditën e emërimit të tij si Ipeshkëv i Administraturës së Jugut të Shqipërisë.

Fort të dashur në këtë moment në zemrën time jehon fort himni i falënderimit të Marisë: *“Shpirti im e madhëron Zotin... sepse e shikoi me pëlqim shërbëtoren e vet të përvuajtë”*.

Po është e vërtetë përballë madhërisë së Hyjit që vepron në jetën tonë, gjithmonë në mënyrë të papritur dhe të habitshme, ndjej nevojën të falënderoj për atë që është duke kryer në jetën time, pavarësisht prej limiteve dhe dobësive të mia njerëzore.

Papa Françesku ka dëshiruar që një misionar nga një qytet i “vogël”, në veri të Shqipërisë (Milot) të bëhet një Bari i një territori të gjerë që përfshin Administratën Apostolike në pjesën jugore të Shqipërisë. Për këtë arsye dua të falënderoj Papa Françeskun për besimin që më ka treguar duke më dërguar mua mes jush si Bari të ri.

Falënderoj menjëherë Shkëlqesinë e Tij Mons. Hil Kabashi, i cili për 20 vjet e udhëhoqi këtë administratë. Jam i sigurt se



sakrificat që ai i ka bërë, sidomos në vitet e para, dhe punën që ai e ka bërë deri më sot, do të vazhdojnë të japin fryte edhe në të ardhmen.

Përshëndes dhe falënderoj të gjithë

meshtarët dhe rregulltarët që punojnë në këtë administratë: besnikëria juaj ndaj Zotit, dëshmia e përditshme dhe heshtja e jetës suaj të kushtuar në shërbim të më të dobëtëve, janë për mua motiv inkurajimi në këtë çast dridhjeje.

Të dashur, kam qenë dërguar nga eprorët e mi në Shqipëri si misionar i Kongregatës të Etërve Barnabitë dhe si misionar kam ndërmend të vazhdoj shërbimin tim. Gjatë gati 25 viteve të meshtarisë sime, njëzet vjet i kam jetuar këtu në Shqipëri. Në këtë Kishë, në mesin e këtij populli kam mësuar të ushtroj ministerin tim, kam mësuar të dëgjoj njerëzit dhe ta bëjë famullinë time familjen time. Për këtë e përshëndes dhe falënderoj bashkësinë e famullisë së Milotit dhe gjithë dioqezën Tiranë-Durrës e cila për mua ka qenë si një nënë. Nënë Tereza e Kalkutës shpesh ka pohuar se ka pasur gjak shqiptari e zemër indiane. Edhe unë mund të them, pa dyshim, se kam gjak italian e zemër shqiptari.

Motoja që kam zgjedhur është “*Kulloti qengjat e mi.*” Ashtu si Pjetri, gjatë mundimeve për tre herë e kishte mohuar Jezuin, pasi kishte kërkuar të konfirmojë dashurinë e tij “*më shumë se të gjithë*”, edhe mua sot Zoti më kërkon t’i kullojë qengjat e tij, popullin e tij, duke filluar nga më të dobëtit, më të varfrit, më të

largëtit. Me ndihmën e “*Bariut të Mirë*” dua të bëhem i afërm të gjithëve për t’i dëgjuar, udhëhequr, mbështetur, mbrojtur e shërbyer.

I përshëndes që nga tani besimtarët e Kishës Katolike, të cilëve së shpejti do t’ua dërgojë një mesazh përshëndetje, edhe besimtarëve të besimeve të tjera që janë të

pranishëm në këtë territor: komunitetin mysliman dhe bektashian dhe vëllezërit e Kishës Ortodokse.

Me ta dëshiroj të marrë rrugë dialogu dhe bashkimi për të qenë gjithmonë shenjë më konkrete e Hyjit për njerëzimin.

Ju përshëndes të gjithëve e lutuni për mua.

Fjalimi i Dom Simon Kullit në ditën e shpalljes si Ipeshkëv i Sapës.

Shkëlqesi e nderuar Imzot Charles John Brown, Nunc Apostolik në Shqipëri,

I nderuar Imzot Massafra Arqipeshkëv Shkodër-Pult, President i Konferencës Ipeshkëvore të Shqipërisë.

I Nderuar Kleri i dioqezit të Sapës, të dashur besimtarë.

Së pari, dëshiroj të falënderoj Bariun e Mirë Krishtin Zot i cili se harron kurrë grigjën e vet dhe përkujdeset gjithmonë për të, e falënderoj Shpirtin Shenjt për çdo të mirë që ka bërë në jetën time, me jetën time dhe për jetën time, që po denjohet të më thërrasë mua të padenjtin si pasues të apostujve për të përjetësuar veprën e Krishtit që është Bari i amshueshëm.

Së dyti, falënderoj Kishën Shenjte Katolike, Shenjtin Atë Papë Françeskun për besimin në mua dhe vlerësimin ndaj jetës sime meshtarake.



Së treti falënderoj klerin e dioqezës së Sapës dhe të gjithë bashkëpunëtorët e ngushtë sepse secili nga ju ka kontribuar që Sapa të shndërrohet në një familje të mrekullueshme, falë

dashurisë që keni treguar dhe vazhdoni të tregoni ndaj meje duke më pranuar ashtu sikurse Zoti ka dashur që të jem.

Të jesh bari i një dioqeze është përgjegjësi e madhe dhe barrë e rëndë, për më tepër të jesh pasardhës i Imzot Avgustinit këtij bariu të mrekullueshëm dhe të pa harruar. Do përpiqem të ndjek gjurmët tija. Dashuria e tij për këtë dioqezë më nxit të pranoj me bindjen dhe fenë e sigurt se Krishti Bariu i mirë është gjithmonë me ne deri në të sosur të botës dhe se kemi mbështetjen dhe ndërmjetësinë e Shenjtës Terezë të Kalkutës, martirëve të Shqipërisë, Zojës së Këshillit të mirë, Pajtores së Shqipërisë. Atyre u besoj vetveten dhe popullin fisnik të Sapës.

Ju faleminderit!

Përshëndetja e Ipeshkëvit të zgjedhur të Rrëshenit, Dom Gjergj Meta

Shumë i Nderuar Atë Kristofor, Bariu dhe Ati i kësaj dioqeze të Rrëshenit, fjalët e para janë për ju sot në shenjë falënderimi për shërbimin dhe të mirën që keni bërë në këto vite, më parë si famullitar e më pas si Ipeshkëv i Rrëshenit. Faleminderit e Zoti të shoqëroftë në vitet në vazhdim. Kjo dioqezë do t’ju kujtojë gjithmonë me respekt dhe dashuri dhe do të keni gjithmonë një vend të veçantë në këtë dioqezë.

Një fjalë dhe një mesazh për mirditorët e mrekullueshëm dhe shumë të vuajtur. Më pranoni si njërin prej jush. Unë i njoh vuajtjet tuaja, kohën dhe shekujt që kanë rënduar mbi ju. Zoti ka dashur që unë të jem bariu juaj në një moshë të re e prandaj ju lutem, me lutjen dhe miqësinë tuaj, bëni të mundur që të jem një i krishterë i mirë bashkë me ju dhe një bari i mirë për ju.

Një fjalë për ju të dashur meshtarë e mo-



tra. Papa Françesku nuk ka zgjedhur më të mirin ndër meshtarët shqiptarë për të shërbyer në këtë dioqezë. Për këtë të jeni të sigurt.

Ka qenë për mua një “po” shumë e vështirë, shumë e vështirë! Ajo që kam është humaniteti im, brishtësia dhe vogëlsia ime. E dorëzohet në duart tuaja që do të jeni bashkëpunëtorët e mi më të afërt. Ashtu sikurse Papa Benedikti edhe unë mund të them se Zoti ka zgjedhur një punëtor të përvujtë në vreshtën e tij. Më ndihmoni të jem një vëlla për ju dhe një bari që jep jetën e tij për delet e veta.

Së bashku të vazhdojmë të çojmë e të kumtojmë gëzimin e Ungjillit në çdo familje të dioqezës, te çdo i ri e sidomos tek të varfrit dhe të mënjauarit e kohës tonë. Kumtimi i Mbretërisë së Hyjit është detyra jonë parësore. Ta bëjmë së bashku këtë gjë pa u kursyer.

Zoti ju bekoftë të gjithëve! Marie Tuci dhe shokët e saj martirë na ndihmojnë në këtë rrugëtim të ri që feja jonë të veprojë nëpërmjet dashurisë.

Ati i shenjtë kërkon edhe fundin e konflikteve e zgjidhje për fenomenin e emigracionit.

(07/07/2017 Papa i drejtohet G20-ës)

Papa Françesku i drejtohet me një mesazh mbledhjes së G20-ës në Hamburg të Gjermanisë, me të cilin kërkon që ekonomia botërore të jetë gjithëpërfshirëse. Duke shtjelluar katër koncepte, Ati i Shenjtë kërkon edhe fundin e konflikteve e zgjidhje për fenomenin e emigracionit.

Katër parime nga Evangelii Gaudium

Në mesazhin e tij, Papa Françesku u paraqet liderëve botërorë, katër parime mbi të cilat duhet bazuar ndërtimi i shoqërive vëllazërore, të drejta e paqësore, marrë nga Nxitja Apostolike “Evangelii Gaudium”. “Koha ka epërsi mbi hapësirën”, është parimi i parë, që përmend Ati i Shenjtë, për të vazhduar më pas me parimet e tjera: “uniteti mbizotëron mbi konfliktin; realiteti është më i rëndësishëm se ideja; e tera ka epërsi mbi pjesët”. Janë linja veprimi, që i përkasin urtisë shumëshekullore të njerëzimit, thekson Papa.

Koha ka epërsi mbi hapësirën. Thirrje për Sudanin Jugor, Çadin, Bririn e Afrikës e Jemenin

Duke shtjelluar parimin e parë, Ati i Shenjtë nënvizon se shumë probleme si varfëria, emigracioni e të tjera, nuk mund të zgjidhen menjëherë, kanë nevojë për kohë. Por, “është e mundur – thekson më tej – të vihen në lëvizje procese, në gjendje të japin zgjidhje progresive e jo traumatike, duke çuar, brenda një kohe relativisht të shkurtër, në qarkullimin e lirë e në qëndrueshmërinë e njerëzve”. Gjithsesi, vëren Papa Françesku, çdo zgjidhje, pavarësisht se e shtrirë në kohë, do të japë fryte, vetëm nëse objektivi përfundimtar mbahet parasysh që në fazën e projektit. Prandaj, politikanët, qysh kur i mendojnë masat për t’u marrë, duhet të kenë parasysh përparësitë për “të varfërit, refugjatët, të vuajturit, të shpërngulurit e të përjashtuarit, pa dallim kombi, race, feje apo kulture”.

Ati i Shenjtë u bën një thirrje të fuqishme krerëve të shteteve e të qeverive për gjendjen në Sudanin Jugor, në zonën e Liqenit të Çadit, në Bririn e Afrikës dhe në Jemen, ku rreth 30 milion vetë nuk kanë ushqim e ujë për të mbijetuar.

Uniteti mbizotëron mbi konfliktin



Protestat në Hamburg kundër G20-ës - AFP

Duke nënvizuar parimin e dytë, marrë nga Nxitja Apostolike “Evangelii Gaudium” e propozuar sot liderëve të G20-ës, mbledhur në Hamburg, Papa Françesku thekson se uniteti duhet të mbizotërojë mbi konfliktet. Në sa afrohet 100-vjetori i Letrës së Benediktit XV për Popujt në Luftë, Ati i Shenjtë Bergoglio kërkon fundin e masakrave të kota nëpër botë. Nuk do të jetë e mundur të arrihen objektivat ekonomike, nëse “palët nuk impenjohen t’i ulin thelbësisht nivelet e konfliktualitetit, të ndalin garën aktuale të armatimeve dhe përfshirjen e drejtpërdrejt ose tërthorazi në konflikte, si edhe të diskutojnë në mënyrë të sinqertë e transparente për të gjitha kundërshtitë”.

Realiteti është më i rëndësishëm se ideja

Ka ikur koha e ideologjive tragjike të shekullit XX, vëren më tej Papa Françesku, por ato janë zëvendësuar me ideologjitë e reja, që privilegjojnë tregun dhe spekulimin financiar. Njeriu në qendër: kjo është ideja e Atit të Shenjtë, i cili “i lutet Zotit që Takimi i Hamburgut të shndritet nga shembulli i liderëve evropianë e botërorë, që kanë privilegjuar gjithnjë dialogun e kërkimin e

zgjidhjeve të përbashkëta: Schuman, De Gasperi, Adenauer, Monnet e shumë të tjerë”.

E gjitha ka epërsi ndaj pjesëve

Zgjidhjet e problemeve, nënvizon së fundi Papa, duke shtjelluar parimin e katërt “E tëra ka epërsi ndaj pjesëve”, për të qenë të qëndrueshme duhet të kenë parasysh pasojat mbi të gjitha vendet e mbi të gjithë njerëzit. Edhe Benedikti XVI, në një mesazh për G20-ën, në vitin 2009, nënvizonte se ajo popullsia, që prodhon vetëm 10% të ekonomisë botërore, është shumica e planetit e vuan më shumë nga kriza ekonomike për të cilën ka pak përgjegjësi, por njëkohësisht, është edhe ajo, që ka “potencialin më të madh për të kontribuar në përparimin e të gjithëve”. Këtu qëndron arsyeja për respektimin e OKB-së, të organizatave rajonale e të traktave ndërkombëtare, të cilat nuk duhen konsideruar fjalë, që mbeten në letër.

Papa Françesku e përfundon reflektimin e tij duke iu lutur Zotit, që me Takimin e Hamburgut të fillojë një epokë të re zhvillimi novator, të ndërlidhur, të qëndrueshëm, që respekton ambientin dhe përfshin gjithë popujt.

Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut

Nga Ferdinand NDOCAJ

Një moment festiv e gëzimi të ligjshëm, përjetojnë sot mbarë besimtarët katolikë shqiptarë. Kurorëzimi i një bilanci pune, përkushtimi i jetës në Krishtin e nderimi i dy figurave rregulltare, këtë herë bëhet, përmes një ceremonie në Presidencën e Republikës së Shqipërisë. Presidenti, z. Flamur Nishani, përshëndetet miqtë e ftuar dhe menjëherë

ekzekutohet “Hymni Kombëtar i Flamurit”; në një atmosferë emocionante, ai vlerëson lart, kontributin e dhënë në drejtim të marrëdhënieve të ngrohta midis Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë; e për këtë në mënyrë specifike, sot ai falënderon imzot Dario Edoardo Viganò, Prefekt i Sekretarisë së Shtetit të Vatikanit për Komunikimin e njehërësh edhe don David Gjugja, drejtues i programit shqip të Radio Vatikanit për 30 vite pa ndërprerje, për të cilët edhe organizohet kjo ceremoni e dhënies së dekorimit me motiva-

cionin si “Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut”...; Sigurisht, Presidenti Nishani, në mënyrë të posaçme, falënderon edhe Nuncin Apostolik të Shqipërisë Imzot Charles John Brown, Imzot Kristoforo Palmierin ipeshkvin e Rrëshenit, e në vijim edhe të afërmit miqtë e dashamirët e tjerë që e nderojnë këtë ngjarje të shënjuar me pjesëmarrjen e tyre.

Presidenti Nishani, në fjalën e tij kujtoi vizitën historike të Papa Françeskut në Shqipëri duke e quajtur atë njeri të jashtëzakonshëm



dhe frymëzues të madh të dialogut. Më pas ai reflektoi në ngjarjet e viteve të fundit dhe sidomos në nderimin që papa Françesku u ka bërë 38 martirëve shqiptarë e deri tek dhurata e tre ipeshkvijve të rinj në kohët e fundit.

Akordohet titulli i nderit dhe medalja “Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut” me motivacionet, që ndër të tjera, për imzot Dario Edoardo Viganò-n, nënvizon: “...përkrahjen e vlerave demokratike të shqiptarëve, si Prefekt i Sekretarisë për Komunikim në Selinë e Shenjtë, dhe si realizuesi i një dokumentari me vlera, për Televizionin e Vatikanit lidhur me vizitën e Papa Françeskut në Shqipëri... ndërsa për Don David Gjurgjen në motivacion vlerësohet kontributi i shquar, për rreth 30 vite, si drejtues i Radio Vatikanit në gjuhën shqipe; vlerësohet ai, si përkthyes zyrtar për gjuhën shqipe, i Papa Gjon Palit dhe i Papa Françeskut, gjatë vizitave të tyre apostolike në Shqipëri; mbi të gjitha shprehet konsiderata si personalitet që ka ndikuar shumë, që raportet midis Selisë së Shenjtë dhe Shqipërisë, Kosovës dhe kudo ku ka shqiptarë, të jenë në nivelin më të mirë të mundshëm”. Gjatë dorëzimit të Medaljeve të nderit “Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut” e në shtrëngimin e duarve bëhen edhe fotot e rastit për ta fiksuar në kujtesë këtë moment tepër domethënës.

Në fjalën e rastit, pas marrjes së medaljes, Imzot Dario Edoardo Viganò dhe Dom David Gjurgja, falënderojnë për nderimin, si shprehje e drejtëdrejtë e një lidhje të fortë, e të qëndrueshme tashmë, mes Shqipërisë dhe selisë së shenjtë.

Kujtesa historike e përjetimeve, e vuajtjeve të gjata dhe persekutimi e martirizimi por, edhe të mbeturit besnik në identitetin e vet, në rrënjët e veta, në fenë e vet, aq sa t’i dhuronte Evropës “*Athleta Christi*”n, Gjergj Kastriotin-Skanderbeg, figurën e ndritur të Kombit shqiptar, emri i të cilit i jep shkëlqim të ri titullit të nderit “Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut”, ishin fjalët që morën theks të veçantë nga të dekoruarit.

U vu në dukje gjithashtu se Zëri i Radio Vatikanit në shqip e ka shoqëruar hap pas hapi udhën e bashkatdhetarëve shqiptarë gjatë viteve të errëta e të dhimbshme të diktaturës komuniste, por edhe u kujtua se në ato studio kaluan personalitete të mëdha, që me fjalën dhe mendimin e tyre, e mbështetën popullin shqiptar në kthesat më të vështira të historisë së tij duke e inkurajuar në kohët e rifitimit të lirisë. Mjafton të kujtojmë dy Shenjtorë: Shën Gjon Palin II e Shenjtëreshën shqiptare Nënë Terezën e Kalkutës.

Në vazhdim u hodh dritë mbi aktualitetin, që u konsiderua si një takim i pandërprerë që vijon me përpikërinë e gatishmërinë karakteristike për mediat e reja, plot vëmendje, për të ndjekur hapat e sukseset e mëtejshme, që pritet t’i arrijë Shqipëria e shekullit të 21-të. Kështu fjala e Atit të Shenjtë vijon të përhapet nga Redaksia shqip, që përbën, në kuptimin më të plotë të fjalës, një urë ndërmjet këtij vendi të lavdishëm dhe Selisë së Shenjtë, ndërmjet Kishës vendase e asaj Universale.

Duke bërë shenjë nga flamuri Don David Gjurgja, Në përfundim të përshëndetjes, përmendi fjalët domethënëse të Papës Françesku, në shtatorin e vitit 2014 në Tiranë: “Mos e harroni shqiponjën. Shqiponja nuk e harron kurrë follenë, por fluturon lart. Fluturoni lart! Shkoni lart. Sot erdha t’ju jap zemër ta përforconi shpresën në ju e rreth jush; t’i vini në lëvizje breznitë e reja; të ushqeheni përherë me fjalën e Zotit, duke ia hapur zemrat Krishtit, Ungjillit të Tij takimit me Zotin e takimit me njëri-tjetrin siç keni bërë gjithnjë: përmes këtij takimi ju i jepni dëshminë tuaj mbarë Evropës”.

Mbyllja e ceremonisë në një atmosferë të ngrohtë e miqësore ia la vendin fotografive, për ta fiksuar në kujtesë këtë moment mjaft të rëndësishëm nderimi e vlerësimi.

Një vlerësim i merituar nga Presidenti i Shqipërisë për prof. Dr. Jul Bushatin - Mjeshtër i madh

Prof. Dr. Jul Bushati, mjek i shquar me një jetë të kushtuar plotësisht në shërbim të shëndetit të popullit e shkencave mjekësore, njëri nga Ambasadorët e Shqipërisë i nderuar pranë *Selisë së Shenjtë*, por edhe besimtar i devotshëm i famullisë sonë të *Shën Palit* në Tiranë, merr titullin “*Mjeshtër i Madh*” nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.

Më dt. 22 qershor, Presidenti i Republikës Sh.T. Bujar Nishani, përmes një ceremonie mbresëlënëse, nderoi Prof. Dr. Jul Bushatin, duke i akorduar titullin *Mjeshtër i Madh*. Ishte një veprimtari sa njerëzorë aq edhe qytetare që pati në qendër të vëmendjes një personalitet të shquar, një figurë të talentuara të mjekësisë shqiptare, një specialistit me kontribute tepër të veçanta në fushën e shëndetësisë e të shkencës në dobi të shëndetit, jetëgjatësisë e kualitetit të jetës çka reflekton vlerë për mbarë shoqërinë shqiptare.

Po cili është Prof. Dr Jul Bushati? Mjeku i nderuar prof. Bushati është një nga figurat e spikatura të mjekësisë shqiptare, që ia ka



kushtuar jetën pa u lodhur shëndetësisë, në diagnostikimin, shërimin e shëndetësimin e me një kontribut shumë të madh në atë të përgatitjes teorike e praktike të mjekëve e të kualifikimit të tyre pasuniversitar ndër vite.

Pasi mbaroi me rezultate të shkëlqyera *Shkollën e Mesme Çajupi*, në Tiranë, atij iu dha e drejta të kryejë studimet për mjekësi në *Universitetin e Tiranës*, në *Fakultetin e Mjekësisë*, në vitet 1962-1967, ku dhe si student la përshtypje e mbresa të veçanta tek pedagogët e studentët e Universitetit e që për rezultatet e arritura u vlerësua dhe me bursë.

Në vitin 1967 kryen studimet dhe diplomohet Mjek i Përgjithshëm në *Fakultetin e Mjekësisë*, *Dega Mjekësi e Përgjithshme* dhe emërohet Mjek në *Institutin e Luftës Kundër Tuberkulozit* në Tiranë. Menjëherë përzgjidhet në kualifikimin 2-vjeçar në specialitetin *Ftizio-pneumologji*, duke u dalluar si asistent i talentuar i Prof. Shefqet Ndroqit. Gjatë periudhës 1967-'80 në sajë të një punë të palodhur realizon shumë studime në plan kombëtar për luftën kundër sëmundjes së tuberkulozit në mbarë vendin, depistime në terren mbi evidentimin e gjendjes së tuberkulozit dhe dhënien e ndihmesës në ngritjen e kapaciteteve të strukturave për rritjen e efikasitetit në luftimin e kësaj sëmundje problematike kombëtare të asaj kohe.

Kryen disa kualifikime pasuniversitare jashtë vendit, në klinika dhe qendra universitare të njohura në botë. Mbresëlënëse janë vlerësimet e profesionistëve të stafit mjekësor në *Spitali Wilhelmina - Vienë*, apo ato të prof. Kunen në *Qendrën Pneumologjike të Vienës*, i njohur si pneumolog në shkallë botërore, i cili duke parë aftësitë e tij profesionale i besoi dr. Julit disa herë edhe drejtimin e konsultave të stafit që ai drejtonte. Gjithashtu, nuk do të harrohen përshtypjet e stafit në *Klinikën Universitare të Pneumologjisë në Universitetin Philipps – Marburg*, Gjermani, në punën shkencore që ai zhvilloi aty për problemin e diagnozës së çrregullimeve mushkërore gjatë gjumit; apo dhe ato në klinika universitare të Italisë, Polonisë, ku ai është edhe vlerësuar për demonstrimin e arritjeve shkencore.

Prof. Bushati ka shënuar arritje të veçanta në drejtime të reja shkencore, si në hapjen e *Repartit*

të Diagnozës Diferenciale dhe Reanimacionit Pneumologjik pranë IFP; në përdorimin e metodave të reja si ajo e teknikës së mikrodrenazhit në trajtimin e Pneumotoraksit; në aplikimin e Amfotericinës B, në mjekimin e mykozave të mushkërisë përmes mjekimit të aplikuar me dren intrakavitar të abscesit të mushkërisë; në aplikimin e mjekimit me dren - transtorakal të aspergilomës së mushkërisë; në aplikimin për herë të parë të ACE në diagnozën dhe ecurinë e kancerit të mushkërisë; realizimit për herë të parë kurbës debit / volum nga kurba e ekspirimit të sforcuar duke përdorur kompjuterin; në hartimin për mikroordinator, në bashkëpunim me informaticienë, të programit për vlerësimin me mikroordinator të kurbës së ekspiracionit të sforcuar; të agobiopsisë transtorakale për kancerin e mushkërisë; shtjellimin e problemit të diagnozës së çrregullimeve mushkërore gjatë gjumit, e shumë veprimtarive të tjera në drejtim të ngritjes së nivelit shkencor në fushën e mjekësisë.

Në vlerësim të performances së tij profesionale ai ka qenë drejtues në disa klinika, drejtues i *Repartit të Diagnozës dhe Terapisë Intensive Pneumologjike* e në vijim edhe zëvendës drejtor për anën teknike në *Institutin e Fiziopneumologjisë e Luftës Kundër Tuberkulozit*; më pas drejtues i klinikave në *Spitalin Universitar të Sëmundjeve të Mushkërive "Shefqet Ndroqi"* deri në vitin 2010.

Në vitin 1986 komandohet në ndihmë të shërbimit *Ftizio-Pneumologjik* në rrethin e Dibrës, ku jep një kontribut të çmuar në ngritjen e nivelit të shërbimit në këtë rreth me incidencë të sëmundjeve të mushkërive.

Prof. Bushati ka dhënë eksperiencë me një kontribut të vyer në arsimin e lartë në fushën e mjekësisë si pedagog në *Fakultetin e Mjekësisë*, në përgatitjen shumëvjeçare universitare të studentëve e kualifikimit pasuniversitarë të tyre, aktivitet të cilin ai e vazhdon edhe në ditët e sotme, duke lënë një trashëgimi në kurrikulat universitare e pasuniversitare në universitetet publike e private, në fushën e mjekësisë, ku spikat puna e palodhur e me përkushtim në udhëheqjen e punimeve shkencore në kuadër të kualifikimeve pasuniversitare të mjekëve.

Ai ka një veprimtari të gjërë shkencore botuese, me libra referime e artikuj shkencorë

brenda e jashtë vendit me prurje të arritura me vlera teorike dhe aplikime praktike në fushën e mjekësisë.

Ka dhënë një kontribut të çmuar në këshillat shkencore të institucioneve shkencore e universitare, në ato botuese, si dhe ato vendimmarrëse etj., ku është shquar për pjekuri e maturi shkencore, profesionale e shoqërore.

Nisur nga arritjet e përkushtimi profesional, thjeshtësia e devotshmëria për t'i shërbyer njerëzve në nevojë, ai u propozua nga Arqipeshkvia e Tiranë – Durrësit tek institucioni i Presidentit të Republikës, i cili e emëroi të përfaqësonte Shqipërinë pranë Selisë së Shenjtë në Vatikan; ku gjithashtu Profesori me vlera e dinjitet e përfaqësoi Shqipërinë duke lënë përshtypjet më të mira në trupën diplomatike të Selisë së Shenjtë. Krahas detyrave shtetërore e zhvillimore për rritjen e dinjitetit e të kapaciteteve strukturore arsimore e shkencore për vendin e tij, gjatë kohës së tij të lirë, i përkushtuar e me devotshmëri, nuk rreshti së asistuar për mbështetjen e zgjidhjes së problemeve shëndetësore të të sëmureve e fëmijëve nga Shqipëria në institucionet shëndetësore italiane, mirënjohje kjo e cila nuk do të harrohet nga mbarë komuniteti shqiptar atje dhe nga Shqipëria.

Në fjalën e tij Prof. Bushati falënderoi Presidentin e Republikës dhe institucionin që ai përfaqëson për vlerësimin e bërë me dhënien e këtij titulli; gjithashtu ai përcolli një falenderim për prindërit e mësuesit e tij për formimin e tij human; profesorët e tij për kontributin profesional, kolegët e bashkëpunëtorët e tij në institucionet universitare e shkencore, si dhe pacientet që i besuan në punën e përbashkët për shërimin e sëmundjeve e shëndetësimin e tyre.

Vlerësimi i një personaliteti të tillë me vlera të mëdha e kontribute të çmuara shumëdisiplinore teorike e praktike në fushën e shkencës së mjekësisë: njeri erudit por modest, mjek i talentuar por i thjeshtë e mbi të gjitha edhe humanist, është modeli i mjekut të vërtetë e që njerëzit në nevojë e kanë quajtur Nënë Tereza, aq të kërkuar në fushën e mjekësisë e më gjerë, për të cilin shoqëria ka nevojë shumë në kohët që jetojmë; Ai mbetet një shembull i njeriut e profesionistit për t'u imituar.

Lëvizja për Jetën në Shqipëri

Lëvizja për Fëmijët të vijnë tek unë

"Ndhimëtarët e Foshnjave të Çmuara të Zoti" me 30 Qershor 2017

kanë kremtuar 7 vjetorin e themelimit të tyre.

Nga. Dr. Majlinda GJONI

Lëvizja për Jetën në Shqipëri, festoi 7 vjetorin e themelimit, me Adhurimin e të Shejtërueshmit Sakramend si dhe me Meshën e Shenjtë ditën e premte më 30 qershor, në Katedralen e "Shën Palit" në Tiranë. Adhurimi u drejtua nga, famullitar i Katedrales Dom Marjan Lumçiqi; ndërsa Meshja e Shejtë u kremtua nga Arqipeshkvi Imzot Charles John Brown.

Më 28 Qershor të 2010 një grup i vogël besimtarësh ka dalur në rrugë për herë të parë për t'u lutur përballë spitalit Mbretëresha Geraldinë dhe që prej asaj dite lëvizja vazhdon të kryejë misionin e saj. Një mision sa i vështirë por edhe i bukur. Pavarësisht vështirësive, nuk ka të krahasuar gëzimi kur një nënë përqafon fëmijën e saj pasi i ka thënë "Po" jetës në vend të abortit.

Shpesh herë njerëzit na marrin si gjykues apo protestues: ne nuk jemi as gjykues as protes-

tues, pasi gjykimi i përket vetëm Zotit. Ne nuk shkojmë me protestue para spitalit! Çdo person që vdes e meriton, që dikush të jetë pranë në momentin e vdekjes! Që dikush të ketë sadopak dhembshuri për të. Ne shkojmë me shoqëruar në lutje, fëmijët e pafajshëm që çdo ditë vriten nga prindërit e tyre. Shoqërojmë me lutje nënat, të cilat shkatërrojnë jetën fizike, por ajo çfarë është më e rëndësishmja, vënë në rrezik shpirtin e tyre. Shoqërojmë me lutje mjekët dhe personelin



ndihmës që Zoti t'i ndriçojë dhe të jenë shërues të të sëmurëve dhe jo vrasës të jetës.

Qëllimi ynë primar, nuk është të shpëtojmë bebe, por të shpëtojmë shpirtat. Fëmijët janë të prekur vetëm fizikisht, por shpirti i tyre shkon në duart e Zotit ndërsa për ato që janë të përfshirë në abort, jeta shpirtërore e tyre është në rrezik për bjerrje të përhershme në qoftë se nuk pendohen dhe nuk i kërkojnë falje Zotit.

Ne edhe pse mëkatarë të pa denjë, mundohemi të shoqërojmë Krishtin në këtë kalvar të ditëve moderne, i cili gjendet jo shumë larg shtëpive tona të banimit. Ne mundohemi të qëndrojmë tek këmbët e Kryqit të Krishtit dhe ta shoqërojmë me lutje siç kanë bërë Zoja Mari dhe Shën Gjoni kur e kanë kryqëzuar në Kryq. Ata nuk kanë protestuar, nuk kanë dënuar, por vetëm janë lutur tek këmbët e Kryqit. Krishti nuk i dënoi por tha: "Fali o Atë se nuk dinë se çfarë bëjmë"...

E kështu pra, përvjetori nisi me një orë adhurimi, gjatë së cilës u falënderua Zoti për bekimet që ka hedhur në punën e "Lëvizjes për Jetën" në këto 7 vite. Përpara të Shenjtueshmit Sakrament, Don Marjani ka udhëheqë lutjen dhe reflektimin mbi Shejtnimin e Jetës dhe ka bashkënda dy dëshmi shumë të fuqishme nga nanat që e kanë përjetue traumën e abortit si dhe gëzimin e madh të pranimit të jetës duke e mbajtur fëmijën. Ishte tepër interesante dëshmia e një rasti kur një nanë pavarësisht vështirësive, për hir të jetës, sakrifikon edhe martesën e saj: *Jeta e jeme martesore u ndërpre pas 4 vitesh. Mendoja se ishim të lumtur sepse nuk na mungonte asnjë gjë. Kishim një ndërmarrje të fuqishme të cilën e drejtonim bashkë me burrin, dhe gjithçka shkonte në mënyrë ma të mirë. Në vitin e katërt të martesës marr prej trupit tem sinjalin ma të gëzueshëm se do të bahem nanë. Vrapoj me shkue deri tek ndërmarrja për me ja dhanë lajmin e mirë bashkëshortit, por... aty ndeshëm me zhgënjimin e jetës teme. Ndërkohë që pritsha se do të më merrte në krabë duke më puthë, jo... ndodh krejt e kundërta: pa lëvizë aspak prej tavolinës së tij, me një sy tek unë dhe tjetrin tek kompjuteri i punës, me një ftohtësi të tmerrshme më thotë: "Nuk mund ta çojmë përpara këtë projekt". Për momentin mendova mos kishte marrë ndonjë e-mail jo fort të mirë për punën dhe thashë nuk e ka kuptue se çka i kam thanë. Duke e shpërfillë çka me tha: ju afrova dhe prapë me gëzim i tham: Presim një fëmijë, unë këtu brenda barku tem të kam ty. Ishte hera e parë që më bërtiste me za të naltë duke*


më dhanë një urdhën të premë: "Duhet ta hjekësh sepse nuk kena kohë tash me u marrë me atë gjë". Dola prej zyrës e mbushun me zemërim dhe ika në shtëpi. Nuk më vinte me kja, por zemra gadi sa nuk po me delte prej vendit. Gëzimi i fëmijës dhe hidhërimi i mospranimit, ishin dy ndjenja që po me dyzonin. Erdhi në mbramje në shtëpi dhe fjala e parë që më tha ishte: "E mbarove atë punë"? Nuk e pritsha një fjalë të tillë prapë prej tij, dhe di vetëm se i kam kërkuë që të arsyetojë se duke vra këtë fëmijë ti po vret jo vetëm veten tënde, sepse je ti brenda meje, por po me vret dhe mua, sepse unë do të mbetem pa ty, dhe ika në dhomën e gjumit për me fjetë. Gjithë natën ai duket se fjeti mirë ndërsa unë nuk vuna gjumë në sy, sepse tashmë po flisja me bebin tim, tashmë e kisha shokun jetës të cilit kisha ëndërruat ti falja gjithçka, pa asnjë kusht: krejt dashninë teme. Duke pa cinizmin e bashkëshortit në mëngjes, vendimi tashma ishte marrë. Sipas tij fëmija duhej të vdiste, ndërsa sipas meje, vdekja e tij do të ishte vdekja e jeme, prandaj UNË VENDOSA TË JETOJMË. Por që të jetonte ai fëmijë dhe unë bashkë me Të, duhej te vdiste lidhja me bashkëshortin, dhe ndamja prej tij ka kenë eksperiencia ma e dhimbshme e jetës seme. Kam fillue prej atij çasti një ecje ne besim, gjë të cilën ma përpara nuk e kisha ba, kjo sepse ishte ai momenti kur unë fillova me e pa dhe me e ndi praninë e Zotit në jetën teme. Kam fillue me e kuptue në ato çaste vuajtjen që Hyji Atë ka pranue

për ne në Birin e Tij. Prej atij çasti vetëm rri dhe e shikoj kryqin dhe sa ma shumë që e shoh, aq ma shumë edhe impresionohem prej Tij, ndërkohë që përpara se ta provoja dhimbjen kryqi për mua ishte një mjet zbukurimit si të gjitha gjanat e tjera që kisha nëpër shtëpi. Jam gjetë para disa zgjedhje që më duhej me i ba: kisha mundësi me urrye, me u hakmarrë, me u dëshpërue, ose... me e lëshue veten në dorën e Zotit. I kam kërkuë Hyjit hirin e dhurimit të dashnisë së pakufishme për djalin tem, dhe sot jetojmë të lumtur. Unë jam e bindun se arsye kryesore e lumturisë teme, nuk asht thjeshtë mosbamia e mëkatit të abortit, sa asht zgjedhja që unë kam ba mes dashnisë për jetë dhe dashnisë për vetveten.

Kështu pra, "Sa më shumë që të dhurosh, aq ma shumë do të marrësh, njëqind për një: sipas mënyrës së Zotit" tha famullitari gjatë adhurimit.

Në vazhdim, Arqipeshkvi Brown, kremtoi Meshën e Shenjtë, duke shpallur rëndësinë për të punuar dhe për të mbrojtur jetën nga ngjizja e deri në vdekjen natyrore. Në homelinë e Meshës së Shenjtë Arqipeshkvi Brown u përqendrua në rëndësinë që ka mbrojtja e jetës:

"Tema e jetës dhe e mbrojtjes së saj, janë një temë që është shumë afër zemrës sime dhe të Papa Françeskut. Papa thotë gjithmonë, me mbrojt më të vegjlit, të varfërit e ata që janë të lënë mbas doret. E kush mund të jetë më i vogël se ata që



ende nuk kanë lindun? Kisha Katolike feston një festë shumë të bukur sot. Martirët e parë të Kishës së Romës. Dje kemi festuar festën e Shën Pjetrit dhe Shën Palit dy mbrojtës të mëdhenj të Romës. Ndërsa sot martirët e Romës, të cilët janë vrarë nën perandorinë Romake. Vëllezër e motra kur shohim jetën e këtyre të krishterëve të parë çfarë shohim ne? Shikojmë dëshminë që ata i kanë bërë Krishtit. Elementi kryesor që kanë dëshmuar është mbrojtja e jetës. Të Krishterët e parë ishin të njohur pasi çdo mëngjes dilnin herët për të kërkuar fëmijët e sapo lindur të cilët lihehin jashtë, të braktisur, për të vdekur. Ishin fëmijë të pa dashtun, ishin pre e vdekjes. Kur shohim këta të krishterë të pare, shohim dëshminë për jetën. Krishti është rruga, e vërteta dhe jeta. Si të Krishterë duhet të ndjekum këtë shembull të mirë të të parëve tanë romak. Për këtë arsye Kisha Katolike nuk mundet mos me dhanë këtë dëshmi në ditët e sotme. Për të mbrojt fëmijët, veçanërisht fëmijët që janë akoma në krahunorin e nënave të tyre. Nga zemra doja me ju inkurajoj që të ecni përpara në këtë apostullim kaq të nevojshëm për kishën e sotme. Le të mendojmë për të gjithë këto viktima të pafajshme të abortit në botë. Të gjithë këto fëmijë të pafajshëm janë një tragjedi vërtet e madhe. Është një tragjedi jo vetëm për fëmijët që nuk u jepet mundësia për të jetuar, por është një tragjedi për nënat të cilat shpesh herë janë të detyruara për të abortuar. Si çdo meshtarë që rrëfen, e din shumë mirë se sa e thellë është tragjedia e abortit. Natyrisht Zoti mundet me fal gjithçka. Jezusi ka mëshirë dhe falje për të gjithë ata që vijnë për pajtim. Por shpesh herë është shumë e vështirë për nënat me e pranue këtë mëshirë pasi kanë përjetue eksperiencën e abortit. Dhe për këtë arsye Lëvizja për Jetën është një lëvizje në favor të grave dhe për gratë. Nuk duhet ta har-



rojmë kurrë këtë fakt. Çdo gjë që bëni në favor të jetës unë e bashkëndaj me ju, dhe ju premtoj se do të jap edhe mbështetjen time personale. Jeta njerzore është dhurata ma e çmuar që na është dhënë në këtë ekzistencë toksore. Në këtë katedrale ne kremtojmë këtë dhuratë të bukur të jetës sonë. Kremtimi Eukaristik do të mbyllet me bekimin e fëmijëve për me e njoh të dhe me e vlerësue dhuratën që ato janë për ne. Faleminderit për ftesen dhe ju kërkoj të luteni për mue, për Papa Françeskun dhe për Imzot Frenon i cili dje ka marrë nga Papa Francesku në Shën Pjeter Paliumin e Shejte. Të ecim sëbashku në favor të jetës.”

Gjatë Meshës, një moment i veçantë ishte oferta në elter ku përveç Bukës dhe Verës u

ofruan disa dhurata simbolike: Qiriu symbol i dritës së Krishtit në botë; Rruzarja e Shejtë si “Arma” e jonë e fuqishme të cilën e përdorim çdo ditë përpara spitalit ku bëhen VRASJET e fëmijëve të pafajshëm. Mjaft emocionant ishte momenti kur një grup fëmijësh iu afruan Arqipeshkëvit. Secili mbante në dorë nga një lule, symboli i jetës dhe i bukurisë së krijimit. Lulet e bardha paraqitën jetët e fëmijë që janë shpëtuar gjatë këtyre shtatë viteve, ndërsa Lulet e kuqe paraqitnin shpirtat e fëmijëve të cilëve nuk u është dhënë mundësia që të lindin.

Zoti na ka bekur gjatë këtyre viteve me dhuratat e Tija të pafund. Na ka bekuar me fëmijë që sot gëzojnë jetën e tyre të lumtur në gjirin e familjes së tyre ose në familjeve adoptuese. Na ka bekuar me nëna që i kanë thënë një herë e përgjithmonë po jetës për fëmijët e tyre. Na ka dhënë nëna të cilat i janë hapur mëshirës së Zotit pasi kanë përjetuar eksperiencën e abortit jo vetëm një herë por disa herë. Zoti nëpërmjet lutjeve ka shndërruar jetët e mjekëve për t’u bërë shërues e jo abortues. Zoti na ka dhurue një një rrjet personash që luten herë pas here për të mbrojtur jetën. Dhe shumë e shumë dhurata pafund. Falënderoj përzemërisht çdo person që ka dhënë kontribut gjatë këtyre viteve në favor dhe në mbrojtje të jetës.

Që ky mision të vazhdojë, ka nevojë për ndihmën dhe suportin tuaj, me lutje në shtëpi apo vendet ku punoni, me lutje përpara spitalit ku bëhen abortet çdo ditë 8:30-9:30. Mund të merrni pjesë në Meshën për Jetën çdo të shtunë në 7:30 në Katedralen e Shën Palit. Në vigiliat që organizohen një herë në muaj etj..

Krishti ka thënë: “ Lërimi Fëmijët të vijnë tek unë”

Kushtet Solemne në Shoqërinë e Jezusit Atë Zef Bisha dhe Atë Stefano Corticelli

Nga Ferdinand NDOCAJ

Mesha e Korpit dhe Gjakut të Krishtit, për “Shoqërinë e Jezusit” në Shqipëri, këtë vit pati një jehonë mjaft festive, pasi u përjetuar me mbresa të veçanta. Famullitari “Zemrës së Krishtit” atë Zef Bisha s.j., si dhe bashkëvëllai atë Stefano Corticelli s.j., morën kushtet solemne. Në ceremoninë eukaristike, ishte Arqipeshkvi Metropolit i Tiranë-Durrësit Imzot George Frenon, por gjithashtu e nderuan eventin me praninë e tyre Nunci Apostolik në Shqipëri Imzot Charles John Brown, Provinciali i Italisë për “Shoqërinë e Jezusit”, shumë etër të tjerë jezuitë nga jashtë e nga vendi, por edhe një numër i madh rregulltarësh e besimtarësh.

Atë Bertrand-Marie Desrois, si epror i Jezuitëve në Tiranë, në çastet e para të kremtimit, bëri paraqitjen solemne përpara bashkësisë së famullisë ‘Zemra e Krishtit’: “Do të jetë momenti i Kungimit”, vuri në dukje “kur atë Zefi dhe Atë Stefano do të bëjnë kushtet e Solemne në Shoqërinë e Jezusit. Është një gjest





dashurie që i bën pjesë aktive në çdo vend e mision ku shoqëria e Jezusit shërben. Për të arritur në këtë pikë, atë Zefi dhe Atë Stefano kanë kaluar në një aventurë të gjatë kushtimi duke njohur Zotin hap pas hapi. Kanë qenë vitet më të bukura ku angazhimi në punën baritore ka filluar që në vitet e para të formimit si Jezuitë dhe menjëherë pas novicjatis bënë kushtet, me të cilat angazhoheshin se do të ndiqnin mënyrën e jetës së Jezuitëve. Tani, ndërkohë që ata bëjnë kushtet e tyre solemne, ‘Shoqëria e Jezusit’ i pranon përgjithmonë, sepse janë në gatishmëri të plotë në misionin universal të Kishës. Historia e Atë Zefit dhe Atë Stefanos është e larmishme dhe e veçantë që i ka dërguar deri në këtë moment.

Atë Zef Bisha ka lindur në Vaun e Dejës më 9 Qershor 1973 dhe në vitet e para, pra rreth 1994-ës filloi të frekuentojë seminarin papnor të Shkodrës. Më pas hyn tek Jezuitët (më 1998). Pas Novicjatis fillon aventura e formimit, në fillim vitet e Filozofisë në Padova, shërbimi për dy vjet në Shkodër, në Seminar me përkujdesen ndaj Seminaristëve, e pastaj në Napoli për vitet e Teologjisë. Etapa e Fundit është në Madrid ku ka studiuar teologjinë shpirtërore dhe është shuguruar prift më 5 Korrik 2008 nga Mons. Luciano Agostini, ipeshkëv i Sapës. Një vit më pas, atë Zefi, ka qenë dërguar këtu në famullinë e “Zemrës së Krishtit”, ku është famullitar që nga 2014. Në përgatitje të kushteve Soleme atë Zefi ka jetuar edhe disa muaj në “Puento Grande” Meksikë duke njohur misionin e Jezuitëve edhe jashtë kontinentit tonë.

P. Stefano Corticelli ka lindur më 17 Qershor 1972 në Chieri, afër Torinos, në një familje ku janë një xhaxha dhe dy kushërinj jezuitë; ka frekuentuar oratorin e Chieri-t dhe ka hyrë në rishtari në 1996. Pas Viteve të studimit në Padova të filozofisë dhe teologjisë, në Napoli ka studiuar teologjinë dogmatike, në Paris duke u shuguruar prift më 24 Maj 2008 nga Mons. Guido Fiandino, ipeshkëv ndihmës i Torinos. Atë Stefano ka punuar me baritoren universitare në Bolonjë dhe nga Tetori është dërguar në Tiranë për misionin e

tij mes jezuiteve në “Famullinë e Zemrës” së Krishtit. Përgatitjen për kushtet Soleme e ka jetuar në Dublin, Irlandë.

Fillimet e Homelisë, së mbajtur nga Arqipeshkvi Metropolit i Tiranës dhe i Durrësit Imzot George Frenzo, shpalosën një analizë organike mjaft domethënëse të leximeve dhe Ungjillit të ditës. “Për misterin eukaristik i cili bëhet i pranishëm nëpërmjet shërbesës kishtare”, duke e lidhur ngushtë edhe me ngjarjen festive të kësaj liturgjie” Imzot Frenzo, tha se: “Kisha e zbaton këtë shërbesë edhe nëpërmjet atyreve që e afrojnë vetveten në jetën e kushtuar. Këta dy meshtarë, në ndjekje të gjurmëve të shën Injacit, i shërbejnë Kishës duke përhapur mbretërinë e Hyjit mbi tokë. Ndër të tjera, pasi iu drejtua pjesëmarrësve, se na përket ne e duhet të lutemi shumë që të gjithë, për jetën e dy etërve tanë që sot marrin kushtet, Imot George Frenzo, nuk nguroi të përmendë gjithashtu edhe shembujt e lartë për një seri etërish jezuitë të famshëm, si atë Arrupe, kardinal Martini, Papa Françesku etj., duke uruar që atë Zefi dhe atë Stefano, t’i mbajnë kurdoherë ata si modele gjatë shërbimit për popullin e Zotit në famulli e më gjerë.



Pjesa më e rëndësishme e solemnitetit të kremtimit ishte marrja e kushteve. Sipas ritualit, të gjunjzuar përpara elterit të shenjtë, atë Zefi dhe atë Stefano shprehën vullnetin e tyre për ta vazhduar me konsekuencë zotimin e ndërmarrë ngaherë, sipas kushteve jetësore tashmë të përhershme. Fill pas shtrirjes së duarve të Arqipeshkvit të dioqezës Imzot Frenzo, mbi dy meshtarët, të pranishmit e shumë të kremtimit, e përshëndetën me duartrokitje të gëzueshme çastin tepër emocionues të krijuar.

Solemniteti i ceremonisë u mbyll me fjalën përshëndetëse të marrjes së kushteve, nga ana e Provincialit të Italisë për “Shoqërinë e Jezusit” atë Gianfranco Matarazzo s.j. i cili tha:

“Në Kishë janë shumë bashkësi rregulltare: Françeskane, Domenikane, Salesiane, motrat e Nënës Teresës dhe për krah tyre gjendemi edhe ne, Jezuitët. Kjo larmi mënyrash për ta jetuar Ungjillin është pasuria e Kishës.

Një përshëndetje shkon për Mons. Frenzo dhe për Mons. Brown që i shërbejnë Kishës në Shqipëri. Si Jezuitë dëshirojmë të japim kontributin tonë në këtë kishë. Jemi në Shkodër, ku punojmë për formimin e brezave të rinj, me një shkollë, dhe këtu në famullinë e “Zemrës së Krishtit”, në Tiranë.

Falënderoj veçanërisht eprorët e dy komuniteteve, p. Marinon, p. Bertrandin por edhe padre Alberton, bashkëpunëtorin tim si i deleguar për Shqipërinë.

Ju drejtohem ju, familjeve të atë Zefit dhe atë Stefanos, faleminderit që na i dhurovat djemtë tuaj Shoqërisë. Jam i ndërgjegjshëm për sakrificën që keni bërë me këto akte. Ungjilli premton një qind herë më shumë atij që lë nënën, babain, vëllezërit. Ja djemtë tuaj janë duke marrë një qind herë më shumë nga nënat, baballarët, vëllezërit. Janë njerëzit këtu prezent që plotësojnë premtimin. Rroftë Shqipëria, rroftë Jezu Krishti!”

Në dalje nga Kisha besimtarëve iu shpërndanë figurat e posaçme me rastin e kushteve të të dy meshtarëve. Me autobusë e mjete të shumta, organizuar më së miri, të gjithë të pranishmit në këtë event u nderuan me një moment banketi festiv në Qendrën “Anton Luli” në Vaqarr.